



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 806/19 Prot.

Tiranë, më 10.08.2026

V E N D I M

Nr. 215, Datë 10/08/2026

Bazuar në nenin 32 dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 110 Regj., datë 29.04.2026 e z. I. Gj., kundër Njesisë Administrative nr. 4, Tiranë, në të cilën pretendon diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues, z. I. Gj., sqaron se ndihet i diskriminuar nga Shërbimi Social i Njesisë Administrative nr. 4, Tiranë, në lidhje me trajtimin e kërkesës së tij për njohjen e përfitimit prej 150% të vlerës së pagesës së verbërisë, sipas VKM nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”. Ai shpjegon se, pasi mori dijeni për kuadrin ligjor përkatës, iu drejtua Shërbimit Social me kërkesë për njohjen e këtij përfitimi dhe dorëzoi dokumentacionin e kërkuar pranë Njesisë Administrative nr. 4. Gjatë shqyrtimit të rastit, u konstatua problem lidhur me emrin dhe vitet e punës në kooperativë, i cili u zgjidh, pas rreth dy vitesh, me vendim gjyqësor.

Pas depozitimit të vendimit gjyqësor, ankuesi pretendon se iu komunikua se plotësonte të gjitha kushtet dhe iu njoh e drejta e përfitimit prej 150%. Megjithatë, pasi mori pagesën për muajin Shkurt 2026, kjo pagesë nuk vijoi për muajin pasardhës (Mars 2026), pa iu dhënë asnjë shpjegim me shkrim. Sipas ankuesit, arsyeja e komunikuar verbalisht ka qenë se nuk ka qenë i verbër gjatë kohës së punës në kooperativë, ndërkohë që ai pretendon se ka qenë i përjashtuar nga shërbimi ushtarak pikërisht për shkak të verbërisë, i klasifikuar në kategorinë e tretë të paaftësisë.

¹Z. I. Gj., sipas vendimit të KMPV Korçë Nr. 799, datë 09.03.1998, dhe vërtetimit nr. 954 prot., datë 14.07.2004, është person me statusin e të verbërit, i komisionuar si invalid pune me diagnozë “degeneration pigmentosa retinae”.

Në përfundim, subjekti ankues i ka kërkuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit dhe zgjidhjen e problemit.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 806/2 prot., datë 04.05.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Tiranë dhe Njësia Administrative nr. 4, Tiranë, lidhur me ankesën nr. 110 Regj., datë 29.04.2026 të z. I. Gj., i cili pretendon diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, duke kërkuar parashtrime me shkrim dhe dokumentacion të detajuar lidhur me trajtimin administrativ të kërkesës së ankuesit për përfitimin 150% sipas VKM nr. 277, datë 18.06.1997.
- Me shkresën nr. 379/3 prot., datë 13.05.2026 të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë, administruar pranë Komisionerit me nr. 806/3 prot., datë 14.05.2026, është përcjellë informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar në lidhje me ankesën e z. I. Gj., si dhe një kopje e përgjigjes së dërguar atij.

- Me shkresën nr. 806/4 prot., datë 14.05.2026, Komisioneri i ka përcjellë ankuesit kopje të parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Tiranë, duke i njohur të drejtën për të paraqitur qëndrimin dhe kundërshtimet e tij. Brenda afatit të lënë në dispozicion, pala ankuese nuk paraqiti asnjë qëndrim apo kundërshtim.
- Me shkresën nr. 1365/1 prot., datë 15.05.2026 të Njesisë Administrative nr. 4, Tiranë, administruar pranë Komisionerit me nr. 806/5 prot., datë 20.05.2026, janë përcjellë parashtrimet e këtij institucioni, si dhe një kopje e përgjigjes së dërguar z. I. Gj., dhe e korrespondencës së zhvilluar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
- Me shkresën nr. 806/6 prot., datë 22.05.2026, Komisioneri i ka përcjellë ankuesit kopje të parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga Njësia Administrative nr. 4, Tiranë. Brenda afatit të lënë në dispozicion, pala ankuese nuk paraqiti asnjë qëndrim apo kundërshtim.
- Me shkresën nr. 806/7 prot., datë 08.06.2026, Komisioneri, për shkak të paqartësive të konstatuara në informacionin e përcjellë nga Njësia Administrative nr. 4, Tiranë, i ka kërkuar këtij institucioni informacion shtesë dhe një qëndrim përfundimtar, të qartë dhe të arsyetuar, lidhur me njohjen e përfitimit 150% sipas VKM nr. 277, datë 18.06.1997, arsyet e ndërprerjes së pagesës për muajin Shkurt 2026, ekzistencën e një vendimi formal për ndërprerjen e përfitimit, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për sqarimin e plotë të rrethanave të çështjes.
- Në këtë kuadër, Njësia Administrative nr. 4, Tiranë, me shkresën nr. 1854 prot., datë 22.06.2026, iu drejtua Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Shërbimit Social Shtetëror, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Licensimit të Bashkisë Tiranë, me kërkesë për interpretim ligjor të pikës 13 të VKM nr. 277, datë 18.06.1997, e cila parashikon se: *“Të gjithë personat e verbër që kanë punuar në ndërmarrje shtetërore ose kooperativa bujqësore para janarit 1991 dhe kanë humbur vendin e punës pas janarit 1991, përfitojnë 150% të vlerës së përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.06.1997, (i ndryshuar), pasi ta kenë vërtetuar këtë fakt me: i) paraqitjen e librezës së punës të fotokopjuar dhe të noterizuar; ose ii) vërtetim nga arkiva, kur të verbrit kanë punuar në kooperativa bujqësore”*.
- Me shkresën nr. 806/9 prot., datë 24.06.2026, Komisioneri iu drejtua Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë dhe Bashkisë Tiranë, me kërkesë për informacion shtesë dhe qëndrim zyrtar lidhur me interpretimin dhe zbatimin e pikës 13 të VKM nr. 277, datë 18.06.1997, në rastin e z. I. Gj., duke kërkuar sqarime mbi kushtet ligjore për përfitimin e pagesës 150%, vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi, përfshirë vendimin gjyqësor për vërtetimin e punës në kooperativë bujqësore dhe dokumentin e përjashtimit nga shërbimi ushtarak për shkak të verbërisë, si dhe qëndrimin e institucioneve mbi ligjshmërinë e njohjes fillestare dhe ndërprerjes së mëpasshme të përfitimit.
- Për sa më sipër, vetëm Bashkia Tiranë përcolli për dijeni shkresën nr. 2362/1 prot., datë 01.07.2026, administruar pranë Komisionerit me nr. 1279/2 prot., datë 06.07.2026,

nëpërmjet së cilës informoi mbi përcjelljen për trajtim të çështjes pranë Njesisë Administrative nr. 4, Tiranë, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Licencimit.

Bazuar në nenin 33/8 të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"², të ndryshuar, dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri caktoi datën 17.07.2026, ora 10:00, për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe njoftoi palët me shkresën nr. 806/10 prot., datë 29.06.2026.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën e planifikuar, në mjediset e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me pjesëmarrjen e palëve, të cilat parashtruan pretendimet dhe qëndrimet e tyre lidhur me çështjen objekt shqyrtimi. Në përfundim të seancës, Komisioneri i la në dispozicion Njesisë Administrative nr. 4, Tiranë, një afat për finalizimin e trajtimit të kërkesës së ankuesit.

Në vijim me email e dt. 30.07.2026 Njësia Administrative nr. 4, Tiranë, përcolli shkresën nr. 2090 prot., datë 28.07.2026, ku njoftoi Komisionerin (*Drejtorinë e Hetimit Administrativ*) mbi ecurinë dhe zgjidhjen e çështjes, duke sqaruar se: *"Pas rishqyrtimit përfundimtar të dosjes fizike dhe vlerësimit të dokumentacioneve të administruara, Njësia Administrative nr. 4 ka konstatuar si vijon: Është shqyrtuar dosja e invaliditetit të punës, ku vërtetuar me vërtetimin nr. 954 prot., datë 14.07.2004, pension i invaliditetit ka filluar me datë 06.01.1992. Ky dokument provon komisionimin si invalid pune me diagnozë "degeneration pigmentosa retinae", pas periudhës së përcaktuar në VKM (janar 1991). Përsa i përket përfitimit të statusit të të verbërit ka filluar me hyrjen në fuqi të aktit ligjor, prej datës 18.06.1997, përfitimi është vendosur me vendimin e KMPV Korçë Nr. 799, datë 09.03.1998. Mbi bazën e këtij kuadri të plotësuar dokumentar, Njësia Administrative nr. 4 konfirmon se z. I. Gj., plotëson kriteret objektive dhe ligjore për të përfituar sipas VKM-së nr. 277, datë 18.06.1997 'Për statusin e të verbërit', duke vijuar me zbatimin dhe duke i njohur këtë të drejtë të plotë në përputhje me legjislacionin në fuqi, reflektimin e listëpagesave të muajit Gusht"*.

Njëkohësisht, me shkresën nr. 1081/4 prot., datë 27.07.2026, Njësia Administrative nr. 4, Tiranë, i ktheu përgjigje drejtpërdrejt z. I. Gj., duke e njohur me të njëjtin qëndrim përfundimtar dhe duke i konfirmuar plotësimin e kriterëve objektive dhe ligjore për të përfituar sipas VKM-së nr. 277, datë 18.06.1997 "Për statusin e të verbërit", si dhe njohjen e plotë të kësaj të drejte në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ndërkohë, me shkresën nr. 806/17 Prot., datë 31.07.2026, është administruar pranë institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi deklarata e ankuesit, z. I. Gj., në të cilën ai shprehet se: *"Unë, ankuesi I. Gj., deklaroj se situata ime është zgjidhur dhe e konsideroj çështjen të mbyllur."*

²Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi": "Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar."

Shpreh falënderimet e mia për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi për kontributin dhe angazhimin e treguar në trajtimin e rastit tim.”

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 20 pika 1/c dhe nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pika 9, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 110 Regj., datë 29.04.2026 të z. I. Gj., kundër Njesisë Administrative nr. 4, Tiranë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, pa një vendim përfundimtar për çështjen, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

